



Perspektiva juaj  
është sfida jonë!

Fondi më i ri në fushën e investimeve

## Raport Muaji Gusht 2024

### Informacion bazë

Administrimi i Fondit	<b>Raiffeisen Invest sh.a</b>
Monedha	<b>LEK</b>
Datë Lancimi	<b>20 Gusht 2018</b>
Datë e mbarimit te Ofertes Fillestare	<b>03 Shtator 2018</b>
Vlera fillestare e kuotës	<b>1,000</b>
Shuma fillestare minimale	<b>30,000</b>
Shuma minimale pasuese	<b>10,000</b>

### Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	<b>0%</b>
Tarifë në dalje	<b>2% (cdo shlyerje para 2 viteve)</b>
Tarifë Administrimi në vit	<b>Deri ne 1.15% e vleres neto te asetëve</b>

Tarifa te tjera te vazhdueshme

Komisione/tarifa e vazhdueshme

Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta

**Referojuni prospektit te fondit**

**1.28% per vitin 2023**

**Referojuni informacionit ne degët e RBAL**

### Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizojë kthimin total afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.

Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqëndruar kryesisht në instrumente borxhi të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, Fondi synon investime afatgjata dhe për këtë arsye, fondi investon të paktën 50 – 80% të asetëve ne obligacione afatgjatë te Qeverisë shqiptare.

Shifra e tarifas së vazhdueshme 1.28% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2023. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund të kalojë maksimumin prej 1.4% ne vit te vlerës neto të asetëve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëvendërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.


### Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë

Përfitimet tipike më të larta




**Profili i parashikuar i Riskut dhe Përfitimit të fondit Raiffeisen Vizion i përket kategorisë së tretë. Ky nivel i treguesit është rezultat i aplikimit të politikës së investimit të fondit me të dhënat historike të normave të interesit për 5 vitet e fundit.** Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk. Ky tregues ka për qëllim tju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

## Të dhëna për Fondin në 31.08.2024

<b>Vlera Neto e Aseteve</b>	<b>10,163,095,436</b>
<b>Numri i investitoreve</b>	<b>3,927</b>
<b>Çmimi i Kuotes</b>	<b>1,214.3170</b>
<b>*Kthimi vjetor neto nga investimi (31.08.2023 – 31.08.2024)</b>	<b>4.45%</b>

\*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

## Struktura e portofolit të investimeve në 31 Gusht 2024



Ne kuader të politikës së investimit të fondit Vizion, investimet kryhen kryesisht në obligacione thesari, të emtuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar dhe transaksioneve në tregun sekondar.

Politika e investimit parashikon që të paktën 50 – 80 % e asetëve të fondit të investohen në obligacione afatgjate të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Fondi mban një pjesë të asetëve në depozita afatshkurtra për të plotësuar në çdo kohë nevojat për likuiditet të investitoreve. Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 10.2 miliardë në datë 31 Gusht 2024.

Instrumenti	Ne % të Asetëve të Fondit
Obligacione Thesari	84.2%
Bono Thesari	1.5%
Depozita / Llogari rrjedhese/ Te arketueshme	0.9%
Marreveshje të Anasjellta të Riblerjes – Rev Repo	13.5%

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një here në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afërsisht një here në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një here në 2 muaj për secilin maturitet.

## Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Gusht

Ne muajin Gusht norma bazë e interesit mbeti e pandryshuar në nivelin 3.00%. Ndersa norma e inflacionit ra me 0.10% ne krahasim me muajin Korrik, duke arritur ne nivelin 2.00% ne Gusht 2024.


Asetet e Fondit Vizion jane te investuara vetem ne bono dhe obligacione te emetuara nga Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe per kete arsye fondi eshte i ekspozuar ndaj ndryshimeve ne normat e interesit te ketyre titujve.

Normat e interesit te titujve te emetuar nga Qeveria Shqiptare kane ndjekur nje trend renes gjate muajit Gusht.

Yieldi i Bonos se Thesarit 12-mujore rezultoi ne 3.151%, duke rene me 0.04% ne krahasim me ankandin e muajit Korrik.

Persa i perket obligacioneve yieldi i obligacionit 2 vjeçar rezultoi ne 3.89% duke mbetur i pandryshuar ne krahasim me ankandin e fundit. Yieldet e obligacioneve reference 3 dhe 5-vjeçar rezultuan ne 4.095% dhe 4.79% duke rene perkatesisht me 0.08% dhe 0.09% krahasuar me ankandet e fundit. Gjithashtu u zhvillua edhe ankandi i obligacionit 15-vjeçar, yieldi i te cilit rezultoi ne 6.98% duke rene me 0.47%.

Grafiket me poshte japin nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Gusht 2023 – Gusht 2024. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yield-et fikse te perlogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Gusht.




## Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri ne 31 Gusht 2024

**Kthimi neto me baze vjetore, per periudhen 31 Gusht 2023 – 31 Gusht 2024 eshte 4.45%.**

Çmimi i kuotes se fondit Vizion eshte rritur me **+0.61%** gjate muajit Gusht. Renia e normave te interesit per obligacionet e qeverise shqiptare ka ndikuar pozitivisht ne portofolin e investimeve te fondit Vizion.


Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic jane ndryshimet e normave te interesit te titujve te borxhit te emetuar nga Qeveria Shqiptare. Keshtu kur normat e interesit ne treg rriten, vlera e titujve te portofolit ulet dhe per rrjedhoje ulet dhe norma e kthimit per periudhen e kaluar. E kunderta ndodh kur normat e interesit ulen. Per pasoje, çmimi i kuotes mund te jete i luhatshem. Luhatshmeria eshte pjese e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi i saj eshte i pamundur, keshtu çmimi i kuotes mund edhe te bjere, jo vetem te rritet.

### Ecuria e çmimit të kuotes Fondi Raiffeisen Vizion



Ne 31 Gusht 2024	1 Vit	2 Vjet	3 Vjet	5 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (3 Shtator 2018)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	4.45%	5.24%	2.88%	3.15%	3.29%

### Kthimi vjetor historik i Fondit Raiffeisen Vizion per çdo vit



Fondi Vizion aplikon nje periudhe minimale qendrimi ne fond prej 2 vitesh. Cdo shlyerje perpara permbushjes se periudhes 2-vjet, normalisht është subjekt i nje tarife dalese prej 2% e vleres se kuotave te shlyera.

**Lutemi te kini parasysh qe Raiffeisen Invest ka bere nje pezullim te perkohshem te tarifes dalese dhe vetem per investitoret qe do te investojne ne fondin Vizion gjate periudhes 27 maj deri ne 27 Shtator 2024 nuk do të aplikohet tarifë dalese.**

Pertej minimumit kohor te qendrimit ne fond, Investitoret e fondit Vizion dhe te gjithe fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter. Per fondin Vizion ky horizont i rekomanduar i qendrimit ne fond eshte te pakten 3 vjet, duke patur parasysh natyrën afatgjatë të investimeve të parashikuara në strategjinë e investimit të fondit dhe ne menyre qe te permbushet objektivi i performancës së fondit.

Investitoret inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Të dhënat per kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premtim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithe shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investitoret per te nxjerre konkluzione per te ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë nje kthim te caktuar te fondit. Informacioni mbi cmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në web site [www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al) ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.